

Tiranë, më 27 Mars 2020

Drejtuar: **Z. Artur Metani**
Inspektor i Lartë i Drejtësisë

Për dijeni: **Z. Olsian Çela**
Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë

Znj. Naureda Llagami
Kryetare
Këshilli i Lartë Gjyqësor

Z. Gentian Ibrahim
Kryetar
Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Nga: **Znj. Erida Skëndaj**
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: *Kërkesë për verifikimin dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjekteve përgjegjës (gjyqtarë/prokurorë) për praktikën e masës së sigurimit ndaj të ndjerit Bilbil Hasani, i vetëvrapur në IEVP 313*

Baza ligjore:

- Neni 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e përditësuar
- Nenet 193 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Nenet 101, 102, 106 - 118 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Nenet 38, pika 2, germa i) dhe 106 të Ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Nenet 17, 46, 59 të Kodit Penal
- Nenet 43 – 46, 228 – 230, 239, 249 pika 4, 49 pika 5, 350 pika 6 të Kodit të Procedurës Penale

I nderuar Z. Metani,

Në datën 21 Shkurt të këtij viti, në Institutcionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale 313 “Jordan Misja”, u gjet i vetëvrapur në qelinë e tij me një çarçaf, shtetasi i paraburgosur me origjinë nga Kukësi, Bilal Hasani, i moshës 43 vjeç. Ky shtetas, sipas medias rezultoi të jetë akuzuar nga prokuroria për vjedhjen e një portofoli në vlerën 1,200 Lek.

Në vijim të kësaj ngjarje tragjike që tronditi opinionin publik dhe tërhoqi vëmendjen e organizatave të shoqërisë civile të të drejtave të njeriut, u njohëm me denoncimin e familjarëve të të ndjerit Bilbil Hasani, në emisionin investigativ Stop, në Tv Klan. Familjarët pretendojnë se praktika e caktimit të masës së sigurimit personal nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe shqyrtimi i kërkesës ankimore kundër masës së sigurimit të depozituar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë janë shoqëruar me shkelje të garancive

procedurale të nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për shkak të situatës së pandemisë, si organizata të shoqërisë civile nuk kemi mundësi të aksesojmë dokumentacionin e prokurorisë dhe atë gjyqësor. Ne jemi mbështetur në të dhënat/indiciet e publikuara në media, dhe më konkretisht procesverbalit të transkriptuar audio të publikuar në media (link: <https://tvklan.al/zbardhet-audio-regjistrimi-gjyqtaret-kishin-dijeni-per-semundjen-e-bilbil-hasanit/>).

I. Cënim i së drejtës të mbrojtjes efektive

Nga CD audio e seancës gjyqësore të realizuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se trupa gjyqësore e përbërë nga znj. Maria Qirjazi (Relatore), znj. Elona Toro, z. Artur Kalaja kanë qenë në dijeni të mbrojtëses ligjore znj. Pustina, e cila ka realizuar përfaqësimin ligjor të personit nën hetim, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, kjo trupë gjyqësore konstatohet se bie në dijeni me pretendimin e shtetasit të paraburgosur se ka zgjedhur mbrojtës ligjor av. Saimir Vishën. Nga komunikimi që i pandehuri ka pasur me familjarët e tij referohet se mbrojtësi i tij ligjor nuk ka qenë në dijeni të datës së zhvillimit të seancës në të cilën do të shqyrtohet ankimi kundër masës së sigurimit.

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, konstatohet se pas vënies në dijeni të mungesës së njoftimit të mbrojtësit ligjor të zgjedhur, trupa gjyqësore anashkalon procedurën verifikuese nëse njoftimi realizuar ndaj mbrojtësit av. Vishaj, është i rregullt dhe nëse mungesa e tij në këtë seancë është e justifikuar, detyrim ky që buron nga nenet 128 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Në kundërshtim me nenet 49 pika 5 dhe 350 pika 6 të Kodit të Procedurës Penale, trupa gjyqësore nuk ka vlerësuar nëse mungesa e mbrojtësit të zgjedhur nga ana e vetë të pandehurit është e përligjur dhe pavarësisht se i pandehuri nuk e ka kërkuar vetë, kjo trupë ka proceduar me caktimin e mbrojtësit kryesisht. Prokurori i çështjes gjyqësore nuk ka shfaqur kundërshtime me mënyrën se si trupa ka vepruar.

E drejta për asistencë ligjore në procesin penal garantohet nga neni 6, pika 3, germa c) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 48, pika 2 të Kartës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, *përcakton aftësinë e kufizuar me qëllim përfshirjen e kategorive vulnerabël, siç janë individët me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilët përballë barrierave të ndryshme mund të hasen me pengesa në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri mbi baza të barabarta me të tjerët. Me qëllim garantimit të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (parashikuar nga neni 6 KEDNJ), praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Strasburgut (GJEDNJ) ka argumentuar si element kyç testimin nëse një individ është i aftë të prezantojë/përfaqësojë çështjen e tij në mënyrë të duhur dhe të kënaqshme pa ndihmën e një avokati.¹*

II. Përdorimi i tepruar i masës së sigurimit “arrestit në burg”

Standardet ndërkombëtare inkurajojnë me forcë mos përdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit penal, deri në dhënien e vendimit, duke mbajtur qëndrimin se heqja e lirisë duhet të zbatohet vetëm kur masat jokufizuese të lirisë nuk mjaftojnë.

¹ Çështja *McVicar v. the United Kingdom*, No. 46311/99, 7 Maj 2002, parag. 48.

Në rastet përjashtimore, kur kufizimi i lirisë vlerësohet si i domosdoshëm, ai duhet të garantojë respektimin e të drejtave dhe garancive me natyrë procedurale të parashikuara në aktet ndërkombëtare që janë të detyrueshme për të zbatuar për vendin tonë si dhe në legjislacionin tonë brendshëm.

Përkundrajt standarteve ndërkombëtare përdorimi i zgjeruar i arrestit në burg në vendin tonë evideton një njohje jo të mirë të tyre nga aktorët e sistemit të drejtësisë penale. Në praktikën e caktimit të masave të sigurimit, vërehet se masa e sigurimit personal ‘arrest në burg’ është një ndër masat e kërkuara për shumicën dërrmuese të të pandehurve nga prokuroria, edhe për vepra penale apo të pandehur që nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë. Po kështu, zbatimi i kësaj mase nga gjykata është sërish në nivele tepër të larta ku referuar një studimi të kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, rezulton se gjykata pranon më së shumti kërkesën e prokurorit. Mbrojtja ligjore që ofrohet nga avokatët e caktuar kryesisht për të pandehurit ndaj të cilëve caktohen këto masa rezulton të jetë e dobët.

Caktimi i masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’ mund të shmangej ndaj shtetasit Bilal Hasani dhe të zbatoheshin alternativa më të lehta të kësaj mase. Përveç se nuk ka kryer një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, izolimi i këtij shtetasi të diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor në paraburgim solli pasoja tragjike në jetën e tij. Gjithashtu ne vërejmë se mbrojtësi i caktuar në mënyrë të parregullt nga ana e trupës gjyqësore të apelit është njohur me aktet e fashikullit gjyqësor në seancë gjyqësore. Koha e shkurtër e njohjes me këto akte, mendojmë se ka cënuar efikasitetin e realizimit të mbrojtjes ligjore. Prova e vetme kundërshtuese e referuar nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht rezulton vendimarrja e KMCAP-së për trajtimin e shtetasit Bilal Hasani me kemp. Nga materialet e publikuara në media rezulton se vendimarrja e KMCAP-së është bazuar në diagnostikimin e këtij shtetasi me “*skizofreni*”, element i cili duhej të merrej në konsideratë si nga Prokurori por edhe nga gjykata, në raport me rrezikshmërinë e ulët të veprës penale për të cilën akuzohej i pandehuri.

Nga materiali i publikuar në media rezulton se gjendja shëndetësore e personit nën hetim, të ndjerit Bilal Hasani, është anashkaluar edhe nga ana e prokurores znj.Elina Kombi.² Gjithashtu, nga investimi i kryer nga ana e medias rezulton se gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë Z. Ardian Kalia, i cili ka realizuar vleftësimin e masës arrest në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ka qenë në dijeni të gjendjes shëndetësore, për shkak se 3 (tre) epikrizat janë depozituar nga ana e mbrojtëses së zgjedhur dhe janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor.

Nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në përgjithësi në këndvështrim të nenit 5 KEDNJ (e drejta për liri dhe siguri) do të ishte e papranueshme që të kufizosh lirinë e një individi me çrregullime të shëndetit mendor, në një mjedis të papërshtatshëm terapeutik.³

Sa më sipër, duke marrë parasysh se pasoja e rëndë e humbjes së jetës (nëpërmjet vetëvrasjes) të shtetasit Bilal Hasani është e pariparueshme, kërkojmë me anë të kësaj shkrese nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, verifikimin dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjekteve përgjegjës (gjyqtarë/prokurorë) për praktikën e masës së sigurimit ndaj të ndjerit Bilal Hasani, i vetërvlarë në IEVP 313.

Gjithashtu, i drejtohem Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm që në ushtrim të kompetencave të tyre, dhe duke nxitur format

² Link: <http://stop.tvklan.al/stop-emisioni-147-sezoni-5-24-mars-2020-skandali-vetevritet-ne-qeli-i-akuzuari-per-vjedhje-qe-kurohej-per-skizofreni/>

³ Çështja *Hutchison Reid v. the United Kingdom*, 50272/99, 20.02.2003.

efektive të bashkëpunimit midis tyre, të kontribuojnë në ndërgjegjësimin e aktorëve të sistemit të drejtësisë që masa e sigurimit “arrest në burg” të zbatohet në mënyrë përjashtimore si masë e fundit, konform standarteve ndërkombëtare por dhe kërkesave të Kodit tonë të Procedurës Penale.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin e deritanishëm, lutemi të merret parasysh kërkesa jonë!

Organizatat nënshkruese:

- 1. Civil Rights Defenders**
- 2. Komiteti Shqiptar i Helsinkit**
- 3. Aleanca LGBT**
- 4. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)**
- 5. Qendra ALTRI**
- 6. Qendra Europiane**
- 7. Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT Shqipëri)**
- 8. Qendra TREJA**
- 9. Qendra Res Publica**
- 10. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF)**
- 11. Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI)**
- 12. Instituti i Studimeve Politike (ISP)**
- 13. Këshilli Shqiptar i Medias**
- 14. Lëvizja Rinore Egjyptiane & Rome (LRER)**
- 15. Organizata “Në familje, për familjen”**
- 16. Në dobi të gruas shqiptare**
- 17. PRO LGBT**
- 18. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)**
- 19. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)**